



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 836 prot.

Tiranë, më 27.03.2024

NJOFTIM ME SHPALLJE

**TË VENDIMIT NR. 1119/10, DATË 25.10.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË
TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESAVE TË
BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. APOSTOL KOSTA"**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e bashkuara të z. Apostol Kosta me nr. 1703 prot., datë 14.07.2020 dhe nr. 1703/2 prot., datë 31.12.2020 në të cilat ngrihen pretendime ndaj magjistrates S. D me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 1119/10, datë 25.10.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. Apostol Kosta", bazuar në nenin 122, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Megjenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, sipas adresës së ankuesit: Instituti i Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Bënçë, Tepelenë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



Konceptoi: Z. Feçi
Pranoi/Miratoi: E.Kuçi
2 (dy) kopje, datë 26.03.2024